# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-394212**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "U fsheh në tualet", policia jep detaje nga arrestimi i Jozefin Markut |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/u-fsheh-ne-tualet-policia-jep-detaje-nga-arrestimi-i-jozefin-markut-i584133` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 5 shtator 2026, 14:24:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 5 shtator 2026, 16:15:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4fcc9a2f4e0b1a9c75a3f47eeab307ef1ffc67cd1463a27ce53e05f85bc7ac02` |
| TEKSTI | `fd92b2eb8bfb5a4218b367237fa95dbef5f59a7c9cdddb6944d8ac7e7342b8db` |
| PAMJA | `a45bfcf5f993ac83b3ae3fc8d63debfd185d89f912e1d0357f7bd1d923a650a4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a68ba360eff051447d2bc31fe7039c4f5c5ff02fc4292e373211beb45f432fef` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326` |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 46991200 |
| TRANSAKSIONI | `0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3` |
| IPFS | `QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz` |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a68ba360eff051447d2bc31fe7039c4f5c5ff02fc4292e373211beb45f432fef`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "U fsheh në tualet", policia jep detaje nga arrestimi i Jozefin Markut

TemA

5 Shtator 2026, 18:15Kronika TEMA




Policia ka zbardhur detaje të reja nga hetimi për dhunimin e 26-vjeçarit Eduart Kuçi, ngjarje për të cilën është arrestuar Jozefin Marku dhe një tjetër person, ndërsa dy të tjerë janë shpallur në kërkim.

Sipas Policisë, 30-vjeçari Jozefin Marku u gjet i fshehur në tualetin e banesës së shtetasit Kristjan Nikolli, 31 vjeç, i cili gjithashtu u arrestua. Në kërkim janë shpallur Anton Huli, 48 vjeç dhe K. V., 27 vjeç.

Në kuadër të hetimeve, shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, kanë kryer një sërë veprimesh për dokumentimin e plotë të ngjarjes dhe identifikimin e personave të përfshirë.

Jozefin Marku, sipas Policisë, akuzohet për veprat penale "Heqja e paligjshme e lirisë", "Plagosja e lehtë me dashje", "Kanosja", "Mbajtja pa të drejtë e uniformës" dhe "Ndërhyrja e padrejtë në jetën private".
Ndërkohë, Kristjan Nikolli, i cili dyshohet se ka qenë drejtues i automjetit tip "Land Rover", akuzohet edhe për "Përkrahja e autorit të krimit" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, bombave ose minave dhe i municionit", krahas veprave të tjera penale.

Gjatë kontrollit të banesës së Nikollit, Policia gjeti dhe sekuestroi një sasi municioni, ndërsa u sekuestrua edhe automjeti tip "Land Rover", i cili dyshohet se është përdorur gjatë ngjarjes.

Sipas hetimeve, Marku dhe personat e tjerë të përfshirë dyshohet se kanë dhunuar Eduart Kuçin, me pretendimin se 26-vjeçari kishte fyer një prej tyre.

Ndërkohë, Policia vijon punën për kapjen e dy personave të shpallur në kërkim, identifikimin e personave të tjerë që mund të kenë marrë pjesë në ngjarje dhe nxjerrjen e tyre përpara përgjegjësisë penale.
Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

## Shkaktuan dy zjarre në Durrës, 3 të dyshuar si piromanë në pranga!

12:35 Kronika / 1 koment

[Zjarri në Himarë, shoqërohet në komisariat një person, dyshohet se i vuri flakën zonës]

12:05 Kronika / 2 komente

KLGJ e KLP i rritën pagën vetes, ministri Gogu: S'do ketë përplasje institucionesh, mosmarrëveshja zgjidhet në Kuvend me ligj

11:25 Kronika / 4 komente

Bilanci i 24 orëve: Ministria e Mbrojtjes: Janë regjistruar 39 vatra zjarri, 6 banesa të djegura në Himarë

10:45 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.